



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 121 prot.

Kamëz, më 17.08.2022

V E N D I M

Nr. 103 Datë 17.08.2022

MBI

**“MIRATIMIN E LISTËS SË FAMILJEVE QË JANË REKOMANDUAR NGA ADMINISTRATORET SHOQËRORË PËR TRAJTIM ME FONDIN 6% TË BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.08.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.91 Datë 12.08.2022 mbështetur në Ligjin 57. Date 18.07.2019”Mbi Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, VKM – në nr.956, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe shërbimet shoqërore” Kreu IV, pika 2 të Vendimit nr. 955 datë 07.12.2016, të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e kriterëve , të procedurave , dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike” të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.5, datë 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%” të ndryshuar kreu IV, pika 3, të VKM nr. 597 dt., 04.09.2019 “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe në VKB nr. 18 datë 18.02.2022 “Mbi miratimin e kriterëve për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit”, **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës së **muajit Korrik 2022, prej 67 familjeve** që janë rekomanduar nga administratoret shoqëror për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.  
Fondi për këto familje është **282,170 (dyqind e tetëdhjetë e dymijë e njëqind e shtatëdhjetë)** lekë.
2. Lista e familjeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi paraqitet në relacionin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

NËN/ KRYETAR KËSHILLI

Ali DAUTI

